# ËNDRRA PËR T'U ZHVILLUAR







PËR KANDIDATËT QË VIJNË NGA KOMU-NITETET JO-SHUMICË, PËRFSHIRË KOMUNITETIN ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIAN, LIGJI SIGURON ULËSE TË REZERVUARA NË UNIVERSITETE.

Unë quhem Nefise dhe vij nga Kosova. Duke filluar nga pozita se ku ndodhem tani dhe duke u kthyer prapa ndër vite, do të ndaj me ju rrugëtimin tim deri më sot për t'u bërë kjo që jam. Do të ndaj me ju momente të rëndësishme të jetës sime – duke eksploruar ngjarje të cilat më kanë bërë të fortë dhe duke iu prezantuar me personat që më kanë mbështetur gjatë gjithë rrugëtimit tim, për t'u përballur me sfida të shumta. Jam krenare që jam rome, që jam ajo që jam sot dhe për ëndrrat për t'u zhvilluar.

Unë jam 49 vjeçare. Punoj si fasilitatore, në përkrahje të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë. Ëndërroj të bëhem mësuese. Aktualisht i jam kthyer shkollimit për t'u diplomuar! Edhe pse kjo është e vështirë për mua si nënë e tre fëmijëve, unë jam e vendosur dhe dua të jem model për fëmijët e mi.

Për një kohë të shkurtër kam punuar si rrobaqepëse. Megjithatë, gjithmonë kam qenë e informuar dhe merrja pjesë nëpër punëtori. Dëshiroja t'u ndihmoj fëmijëve të komunitetit tim për të pasur arsim cilësor. Përfundimisht, me një vendosmëri të madhe, u bëra fasilitatore në Qendrën mësimore për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë.





1,753 ROMË JANË TË REGJISTRUAR SI TË PAPUNË, NDËRSA 38 JANË TË PUNËSUAR.

2,639 ASHKALI JANË TË PAPUNË, NDËRSA 40 JANË TË PUNËSUAR.

838 EGJIPTIANË JANË TË PAPUNË, NDËRSA 45 JANË TË PUNËSUAR.

NË INSTITUCIONET PUBLIKE PARASHKOLLORE NUK KA PROFESIONISTË ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIANË TË ZHVILLIMIT TË HERSHËM TË FËMIJËVE. NË QENDËRA MËSIMORE QË OFROJNË PROGRAME TË ZHVILLIMIT TË HERSHËM TË FËMIJËVE KA RRETH 35 PARAPROFESIONISTË ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIAN.

*Vebi Mujku, Monitorimi i Strategjisë sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për efektivitetin e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP-të) për punësimin e anëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, KOSINT, 2019, fq. 9.Në dispozicion në: http://kosint2020.net/site/assets/files/1446/mon- itoring_of_sector_strategy_of_the_mlsë_on_the_effectiveness_of_almms_for_the_ employment_of_members_of_roma-_ashkali_and_e-1.pdf.*

Menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme, u regjistrova në shkollën e lartë. Dëshiroja të ndjek pasionin tim për të shkruar duke studiuar për daktilografiste profesional.

Fatkeqësisht, shkolla e cila e ofronte këtë program u mbyll dhe unë mbeta në udhëkryq. Familja ime ishte keq financiarisht dhe kështu hoqa dorë nga ëndrra ime.

PJESËMARRJA NË ARSIM BIE NGA 5,793 NXËNËS ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIANË NË SHKOLLË FILLORE NË 582 NXËNËS NË SHKOLLË TË MESME TË LARTË.

***Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Agjencia e Statistikave të Kosovës, STATISTIKAT E ARSIMIT NË KOSOVË-Sistem për menaxhimin e Informatave në Arsim, 2019, fq. 27. Në dispozicion në: http://masht-smia.net/Publikimet/37ALB.pdf***





PJESËMARRJA E FËMIJËVE ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIANË NË ARSIMIN FILLOR ËSHTË RRETH 85%.

VETËM 65% E KËTYRE NXËNËSVE E VAZHDOJNË ARSIMIN E MESËM TË ULËT.

*ILO, Ada Huibregtse, Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, Komuna e Gjakovës, Fushë Kosovës dhe Graçanicës, 2018.*

Në shkollën fillore isha ndër vajzat e pakta rome. Falë angazhimit të prindërve të mi, mësova shpejt që të lexoj dhe shkruaj. Të shkruarit u bë pasioni im. Mirëpo, shkolla nuk qe e lehtë për mua sepse përballesha me diskriminim.



Vitet e mia të hershme ishin të shkëlqyeshme. Më pëlqente të luaja jashtë me shoqëri në rrehin tim. Që e vogël, bëja gjoja se isha më- suese duke luajtur.



## SHKALLA E VDEKSHMËRISË SË FOSHNJEVE NGA KOMUNITETI ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIAN ËSHTË TRE HERË ME E LARTË SE E FËMIJËVE TË POPULLSISË SË PËRGJITHSHME.

*UNICEF, Children in Kosovo. Available at: https://www.unicef.org/kosovoprogramme/children-kosovo*

Rrjeti "Kosovo Roma, Ashkali, and Egyptian's Early Years Network" - KRAEEYN është një rrjet profesionistësh dhe paraprofesionistësh të cilët mbështesin komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë. Ky rrjet u themelua në vitin 2016.

KRAEEYN punon për zhvillimin e shkathtësive dhe praktikave të mira për të krijuar partneritete efektive dhe për të mbështetur ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve dhe paraprofesionistëve që punojnë me fëmijët romë, ashkali, dhe egjiptianë në qendra mësimore, inistucione parashkollore, shkolla. Rrjeti promovon qasje të barabartë në arsim në fëmijëri të hershme për fëmijët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë përmes avokimit për gjithëpërfshirje dhe përmirësim të cilësisë së ofertës.

Rrjeti KRAEYN ka më shumë se 150 anëtarë individualë dhe 8 organizata anëtare që avokojnë për mirëqenien e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe përfshirjen e tyre në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës duke avokuar për gjithëpërfshirje dhe përmirësim të cilësisë së arsimit.

Na ndiqni në Facebook: www.facebook.com/kraeeyn

Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center
KEC

Kosovo Roma Ashkali and Egyptian
KRAEEYN
Early Years Network

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është organizatë joqeveritare
KEC ka një numër partnerësh vendorë dhe ndërkombëtarë, të
dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2000, për t'u fokusuar
në cilët përbëjnë organizata joqeveritare, programe konsulence
aftësimin e mësimdhënësve në vendin e punës. Që kompani,
agjenci zhvillimore dhe institucione shtetërore. Që nga atëherë

KEC ka zgjeruar fushëveprimin në katër fusha kryesore: 1) 2004,
shkolla "Mileniumi i Tretë" funksionon në kuadër të KEC Cilësia e
arsimit, 2) Të drejtat e njeriut; 3) Rrjetëzimi dhe pjesëmarrja në
dhe ofron aktivitete të arsimit fillor dhe të mesëm. politikëbërje,
dhe 4) Kërkimi shkencor në arsim.

***Të dhënat e paraqitura në këtë fletushkë janë nga Kosova. Ato janë rezultat i kërkimit dhe monitorimit të bërë nga KREYN dhe organizata nikoqire e të cilave është Qendra për Arsim e Kosovës.***